

VENDIM
Nr. 712, datë 11.11.2022

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I RRUGËS ‘AGO ÇELI’ DHE ‘RRUGËS SË RE’, SI
DHE ‘RIKONCEPTIMI I PALESTRËS SË LAGJES ‘15 SHTATORI’, TEPELENË”**

(Ndryshuar me VKM-në nr.395, datë 19.6.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës ‘Ago Çeli’ dhe ‘Rrugës së Re’”, si dhe ‘Rikonceptimi i palestrës së lagjes ‘15 Shtatori’, Tepelenë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tepelenë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 14 342 568 (katërmëdhjetë milionë e treqind e dyzet e dy mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit është 14 342 568 (katërmëdhjetë milionë e treqind e dyzet e dy mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë dhe përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale,¹ në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë justifikues për likuidim pranë Bashkisë Tepelenë, e cila e përcjell dokumentacionin zyrtarisht pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tepelenë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tepelenë për pasuritë e shpronësuara.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, pasqyron në kartelat e pasurive të paluajtshme informacionin për miratimin e shpronësimit për interes publik të pasurive, pronë private, të cilat preken nga realizimi i projektit. Regjistrimi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Tepelenë kryhet pas aplikimit nga Bashkia Tepelenë për shërbimin përkatës.

¹ Vendimi nr.395, datë 19.6.2024 botuar në F.Z nr.105 datë 26.6.2024 në pikën 2 të tij shprehet: “Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Tepelenë.”

12. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Tepelenë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

Lista e shpronësimit të pronarëve të pasurive pronë private që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës ‘Ago Çeli’ dhe ‘Rrugës së Re’ , si dhe ‘Rikonceptim i palestrës të lagjes ‘15 Shtatori’, Tepelenë”

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ASHK-së TEPELENË)											VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME	
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK.	Nr. i pas	Lloji i pas.	Sip. Tot (m²)	Shpronësime toke "truall"			Ndërtesë jo banimi		Ndërtesë banimi				
								Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m³)	Vlera (lekë)	Sip. nd. konf. nga ZVRPP (m²)	Vlera sipas Preventivit (lekë)	Sip. nd. konf. nga ZVRPP (m²)	Çmimi sipas EKB-së (lekë)			Vlera sipas EKB-së (lekë)
1	Valentina	Ismahil	Muska	3574	14/300	truall+ndërtesë	60	60	1015	60.900	97	2,246,354	0	0	0	2,307,254.00	Objekt 2K SEKSIONI C. Të drejtat reale 27.4.2014 MBI KËTË TRUALL NDODHET NDËRTESA ME NR. PASURIE. 30/60- ND, VOL. 8. FAQE 116 SEKSIONI D. Kufizimet e pronësisë 14.5.2002 LIROHET PASURIA NGA BLOKIMI NË FAVOR TË BANKËS SË KURSIMEVE SHA; 27.4.2014 NDALOHEN VEPRIMET MBI PASURINË URDHËR KUFIZIMI; 4.7.2017 NË BAZË TË DEKLARATËS NOTERIALE NR. 1554 REP. 882 KOT DATË 28.6.2017 KJO PASURI LIROHET NGA BARRA HIPOTEKORE PËR LLOGARI TË FONDIT BESA SHA; E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN BLERË TRUALLI ME REF 00000275 OBJEKTI LOKAL TREGTAR DY KATE
2	Natasha	Alem	Balili	3574	16/220	truall+ndërtesë	32	32	1015	32,480	32	1,112,798	0	0	0	1,145,278.00	SEKSIONI D. Kufizimet e pronësisë Nuk ka shënime në kartelë
	Gazmend	Zaho	Balili														
	Klodian	Zaho	Balili														
	Marsel	Zaho	Balili														
	Shefiko	Kasëm	Sala	3574	14/307-ND	ndërtesë	50	0	0	0	50	2,035,262	0	0	0	2,035,262.00	SEKSIONI C. Të drejtat reale 27.4.2014 NDËRTESA NDODHET MBI TRUALLIN ME NR. PASURIE. 14/307 VOL. 15 FAQE 32. SEKSIONI E. NË BAZË TË URDHËRIT TË REGJISTRUESIT HIQET MASA E KUFIZIMIT MBI PASURI
	Aurora	Maksim	Lazaj														
3	Matilda	Maksim	Çela														
	Anisa	Maksim	Skenderi														
	Albano	Maksim	Sala														
4 ²	Iljaz	Çobo	Qori	3574	16/445 ND	Ndërtesë	160	0	0	0	0	0	160	28,320.6	4,531,296	4,531,296	Konfirmuar nga ASHK-ja Shtëpi banimi 2-katëshe.

² Vendi nr.395, datë 19.6.2024 botuar në F.Z nr.105 datë 26.6.2024 në shprehjen b) të pikës 1 të tij shprehjet: “Në tabelën bashkëlidhur vendimit, të dhënat e nënndarjes me numër rendor 4, që i përkasin pasurisë nr. 16/97, zona kadastrale 3574, zëvendësohen me të dhënat e pasurisë me nr. 16/445 ND, të pasqyruara në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.”

																	Kati përdhes 80 m2 dhe kati i parë 80 m2.
5	Aristidh	Sami	Rushiti	3574	16/308	truall	405	30	1015	30,450	0	0	0	0	0.0	30,450.00	SEKSIONI D. Kufizimet e pronësisë 6.7.2016 NDALOHEN VEPRIMET MBI PASURINË
6	Sherif	Çobo	Selimi	3574	14/281	truall+ndërtesë	50	50	1015	50,750	50	1,709,792	0	0	0	1,760,542.00	SEKSIONI D. NUK KA SHËNIME NË KARTELË SEKSIONI E. NUK KA SHËNIME NË KARTELË
7	Edlira	Muha	Jovani	3574	14/14	truall+ndërtesë	30	30	1015	30,450	21.2	939,889	0	0	0	970,339.00	SEKSIONI D. NUK KA SHËNIME NË KARTELË SEKSIONI E. NUK KA SHËNIME NË KARTELË
	Emblika	Myftar	Muha														
	Ilirjan	Xhemo	Muha														
	Manjola	Xhemo	Muha														
	Matilda	Xhemo	Muha														
8	Votim	Xhemal	Asllani	3574	16/309	truall	413	28.5	1015	28,927	0	0	0	0	0	28,927.00	SEKSIONI D. 14.11.2016 BLOKOHET PASURIA NË FAVOR TË BANKËS POPULLORE PËR SHUMËN 1800000 LEKË; 8.7.2016 BLOKOHET PASURIA NË FAVOR TË KREDITORIT MANE RUSHITI PËR SHUMËN 2700000 LEKË. KONTRATË; 8.7.2016 MBI KËTË PASURI KA 3 NDËRTIME PA LEJE URDHËR PËR INFORMIM; 06.07.2016 NDALOHEN VEPRIMET MBI PASURINË URDHËR KUFIZIMI; SEKSIONI E: DIFERENCA FAKT-DOKUMENT = 20 m²
9	Pajtim	Lutfi	Ruçi	3574	16/178	truall+ndërtesë	25	25	1015	25,375	25	1,507,845				1,533,220.00	SEKSIONI D. NUK KA SHËNIME NË KARTELË SEKSIONI E. NUK KA SHËNIME NË KARTELË
Vlera totale e shpronësimit																14,260,649.10	

Shënime.

1. Vlerësimi i tokës truall është llogaritur bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.
2. Vlerësimi i objektit “ndërtesë banimi dhe jobanimi” është bërë në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar.